

Programi zgjedhor për lëndën e lirë zgjedhore

SHAH

Shkup, 2022

LIDHJA ME STANDARDET KOMBËTARE

Programi mësimor përfshin kompetenca përkatëse nga fushat në vijim: Zhvillimi personal dhe shoqëror dhe Matematika dhe shkencat natyrore.

Nxënësi/nxënësja di dhe/ose mund:

V-A.2	të zgjedhë dhe të praktikojë aktivitete që sigurojnë zhvillimin dhe përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies së tij mendore dhe fizike
V-A.4	të bëjë vlerësimin e aftësive dhe arritjeve të veta (duke përfshirë pikat e forta dhe të dobëta) dhe, mbi këtë bazë, të përcaktojë përparësitë që do t'i mundësojnë zhvillim dhe përparim
V-A.5	të njohë emocionet e vetja dhe të tjerët, të kuptojë pasojat e reagimeve të veta emocionale në situata të ndryshme dhe të përdorë strategji të përshtatshme për përballimin e emocioneve
V-A.6	të vendosë qëllime për të nxënë dhe për zhvillimin personal dhe të punojë për të kapërcyer sfidat që paraqiten në rrugën drejt realizimit të tyre
V-A.7	të përdorë përvojat e veta për ta lehtësuar të nxënë dhe për ta përshtatur sjelljen e vet në të ardhmen
V-A.8	të organizojë kohën e vet në mënyrë që të mundësojë realizimin efikas dhe efektiv të qëllimeve të vendosura dhe të përmbushë nevojat e veta
V-A.9	të parashikojë pasojat e veprimeve të veta dhe të veprimeve të tjerëve mbi vetveten dhe mbi të tjerët
V-A.10	të aplikojë parime etike në vlerësimin e asaj që është e drejtë dhe e gabuar në veprimet e veta dhe të tjerëve, dhe të shfaqë tipare të mirëfillta karakteri (si ndershmëri, drejtësi, respekt, durim, kujdes, mirësjellje, mirënjohje, vendosmëri, guxim dhe autodisiplinë)
V-A.13	të komunikojë me të tjerët dhe të prezantohet vetë në mënyrë të përshtatshme për situatën
V-A.17	të kërkojë informacion dhe mbështetje për veten, por edhe të japë informacion konstruktiv dhe mbështetje në dobi të tjerëve

V-A.18	të hulumtojë, duke bërë pyetje relevante, me qëllim të zbulojë problemet, të analizojë dhe vlerësojë informacionet dhe propozimet, dhe të verifikojë supozimet
V-A.21	të analizojë, vlerësojë dhe përmirësojë të nxënit e vet
III-A.25	të vendos se si të kontrollojë rezultatet dhe të merr në konsideratë nëse përgjigjja është e arsyeshme në kontekstin e problemit
III-A.26	të vlerësojë efektivitetin e qasjeve të ndryshme për zgjidhjen e problemit dhe të përmirësojë procedurën e zgjidhjes.

Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:

V-B.3	arritjet dhe mirëqenia e vet varen në masë të madhe nga përpjekjet që bën vetë dhe nga rezultatet që arrin vetë
V-B.6	suksesi në jetë, në masë të madhe, varet nga qëllimet që vendos vetë, dhe nga mënyra se si planifikon aktivitetet dhe organizon kohën, në masë të madhe varet efikasiteti dhe efektiviteti në realizimin e qëllimeve të vendosura
V-B.7	iniciativë, këmbëngulje, durim dhe përgjegjësi janë të rëndësishme për realizimin e detyrave, arritjen e qëllimeve dhe kapërcimin e sfidave në situatat e përditshme
V-B.9	kërkimi i feedback-ut dhe pranimi i kritikës konstruktive çon në përparim personal në nivel individual dhe social.

REZULTATET NGA MËSIMI

Tema 1. Studimi i figurave të shahut dhe mënyra se si lëvizin

Njohuri/aftësi:

- Njoh të gjitha figurat e shahut.
- Kupton si lëvizin figurat e shahut.
- Kupton çfarë është promovimi i pionit dhe si promovohet një pion.

- Ditur të vendosë figurat e shahut në pozicionin fillestar.

Qëndrimet/vlerat:

- Respekton dhe kupton se duhet të presë radhën për të shprehur njohuritë e tij/saj.
- Ka qëndrim pozitiv ndaj lojës së shahut.
- Kupton se duhet respektuar rregullat e lojës.

Përmbajtjet (dhe nocionet) dhe numri i orëve

Shembuj të aktiviteteve:

- **Të mësuarit e figurave të shahut, mënyra e lëvizjes së tyre dhe vlera që kanë**

(pioni, kështjella, oficeri, kali, mbreti, mbretëresha)

Numri i orëve: 4

- Mësimdhënësi tregon një video edukative në internet për secilën figurë të shahut veç e veç.
- Mësimdhënësi tregon si lëviz secila figurë veç e veç.
- Çdo nxënës i afrohet tabelës së shahut dhe tregon si lëviz secila figurë.
- Pasi nxënësit të zotërojnë mënyrën e lëvizjes së një figure, kalojnë në mësimin e figurës tjetër.

- **Promovimi i pionit**

(promovimi i pionit në figura të tjera)

Numri i orëve: 1

- Mësimdhënësi tregon një video edukative në internet dhe shpjegon çfarë do të thotë promovimi i pionit dhe kur mund të bëhet ai.

- **Vendosja e figurave në pozicionin fillestar**

Numri i orëve: 1

- Mësimdhënësi tregon një video edukative në internet, shpjegon çfarë do të thotë pozicioni fillestar i figurave dhe si vendosen ato.
- Çdo nxënës i afrohet tabelës së shahut dhe vendos figurat në pozicionin fillestar.
- Nxënësit ndahen në grupe prej dy vetash, çdo grup ka nga një tabelë shahu përpara vetes, dhe secili nxënës duhet të vendosë figurat e veta (të bardha ose të zeza) në pozicionin fillestar.

- **Mësimi praktik**

- Numri i orëve: 6

- Nxënësit ndahen në çifte, dhe çdo grup ka nga një tabelë shahu me figura. Nxënësit përsërisin/ushtrojnë termat e mësuar nga tema.

Tema 2. Bazat e lojës së shahut

Njohuri/aftësi:

- Ditet t'i lëvizë figurat në tabelën e shahut sipas rregullave

- E njeh mënyrën se si të sulmojë dhe të marrë një figurë kundërshtare.
- Di të japë shah.
- Di të mbrohet nga shahu.
- Di të japë mat me një lëvizje.
- E di çfarë është pat.
- E kupton dallimin mes shahut, matit dhe patit.
- Kupton çfarë është rokada dhe an pasan.

Qëndrimet/vlerat:

- Pranon se duhet të respektohet kundërshtari.
- E kupton se në lojën e shahut ka fitues dhe humbës.
- Është i/e gatshëm të ndërmarrë veprime për të arritur fitoren.

Përmbajtjet (dhe nocionet) dhe numri i orëve

Shembuj të aktiviteteve:

- **Lëvizjet bazë në shah, sulmi dhe marrja e figurës kundërshtare dhe mbrojtja e figurave të veta** (rregullat bazë të lojës)
Numri i orëve: 2

- Mësimdhënësi shfaq një video edukative nga interneti dhe shpjegon lëvizjet bazë të shahut dhe lëvizjet më të mira për fillimin e një partie.
- Mësimdhënësi jep detyra shahu ku nxënësit duhet të zgjidhin se si të sulmojnë një figurë kundërshtare me një lëvizje. Mësimdhënësi në mënyrë të alternuar pyet secilin nxënës të zgjidhë të paktën një detyrë të tillë.
- Nxënësit ndahen në grupe prej dy vetash, çdo grup ka nga një tabelë shahu dhe vendosin figurat në pozicionin fillestar. Nxënësi me figurat e bardha fillon lëvizjen e parë sipas rregullave të mësuara për lëvizjen e figurave dhe për rregullat e sulmit dhe marrjes së figurave të shahut.

- **Shah, mat dhe pat** (Studimi i nocioneve dhe rrethanave se si të jepet shah, mat apo pat dhe si të mbrohet nga shah)
Numri i orëve: 3

- Mësimdhënësi shfaq një video edukative nga interneti dhe shpjegon se çfarë është shahu.
- Mësimdhënësi vendos detyra shahistike në të cilat nxënësit duhet të zgjidhin si të japin shah me një lëvizje. Mësimdhënësi i pyet me radhë secilin nxënës që të zgjidhë të paktën nga një detyrë të tillë.
- Mësimdhënësi vendos detyra shahistike në të cilat mbreti është nën shah, ndërsa nxënësit duhet të gjejnë mënyrën si të mbrohen nga shahu.

	• Mësimdhënësi shfaq një video edukative nga interneti dhe shpjegon se çfarë është mati. • Mësimdhënësi vendos detyra shahistike, në të cilat nxënësit duhet të zgjidhin se si të realizojnë mat me një lëvizje. Mësuesi i drejtohet me radhë secilit nxënës, duke i kërkuar të zgjidhë të paktën një detyrë të tillë. • Mësimdhënësi vendos detyra shahistike në të cilat nxënësit duhet të zgjidhin si të japin mat me një lëvizje. Mësimdhënësi i pyet me radhë secilin nxënës që të zgjidhë të paktën një detyrë të tillë. • Mësimdhënësi shfaq një video edukative nga interneti dhe shpjegon se çfarë është pat. • Mësimdhënësi vendos detyra shahistike në të cilat nxënësit duhet të zgjidhin si të japin pat me një lëvizje. Mësimdhënësi i pyet me radhë secilin nxënës që të zgjidhë të paktën një detyrë të tillë.
Rokada dhe en passant Numri i orëve: 2	• Mësimdhënësi shfaq një video edukative nga interneti dhe shpjegon se çfarë është rokada, dhe cilat janë rregullat kur mund të bëhet rokada dhe kur jo. • Mësimdhënësi vendos detyra shahistike dhe e pyet secilin nxënës me radhë nëse mund të bëhet rokada dhe ta realizojë atë. • Mësimdhënësi shfaq një video edukative nga interneti dhe shpjegon se çfarë është "en passant". • Mësimdhënësi vendos detyra shahistike dhe e pyet secilin nxënës me radhë nëse mund të bëhet "en passant" dhe ta realizojë atë.
Mësimi praktik Numri i orëve: 7	• Nxënësit ndahen në grupe prej dy vetash, dhe çdo grup ka nga një tabelë shahu me figurat përkatëse. Nxënësit i përsërisin/ushtrojnë nocionet e mësuara nga tema.

Tema 3. Parimet themelore të zhvillimit të një partie shahu

Njohuri/aftësi:

- Di të zhvillojë figurat shahistike.
- Di të japë shah dhe mat.
- Di të luajë në një turne shahu.
- Zbaton të menduarin logjik dhe kritik gjatë lojës.
- Tregon lojë të ndershme.

Qëndrimet/vlerat:

- Respekton punën në grup.
 - Pranon se duhet të jesh dinjitoz në fitore.
 - Është i/e gatshëm/gatshme ta shndërrojë humbjen në mësim.
 - Ka qëndrim pozitiv ndaj garave në shah.
 - Dënon sjelljen e pandershme gjatë partisë dhe turneut në përgjithësi.
 - Beson se puna e palodhur është rruga drejt suksesit.

Përmbajtja (dhe nocionet) dhe numri i orëve

Shembuj të aktiviteteve:

- **Tri rregulla të arta të lojës në hapje**
(Pion në qendër të tabelës, zhvillim i shpejtë i figurave të lehta dhe rokada)
Numri i orëve: 2

- Mësimdhënësi shfaq një video edukative nga interneti dhe shpjegon cilat janë tre rregullat e hapjes në një parti shahu.
- Në fund të çdo ore, nxënësit ndahen në grupe prej dy vetash, secili grup ka një tabelë shahu dhe luajnë hapje shahiste duke u përpjekur të aplikojnë parimet themelore të mësuara për hapjet në shah.

- **Mat me Damë**
Numri i orëve: 2

- Mësimdhënësi shfaq një video edukative nga interneti për matjen me damë.

- **Parti shahu dhe turneu përfundimtar i shahut** (Ku çdo pjesëmarrës do të marrë diplomë për pjesëmarrje, ndërsa tre të parët medalje – të artë, të argjendtë dhe të bronzte)

- Mësimdhënësi organizon një garë shahu ku i mëson fëmijët për lojën e ndershme, sjelljen kulturore dhe respektin ndaj kundërshtarit. Për secilin pjesëmarrës sigurohet një diplomë për pjesëmarrje, ndërsa për tre më të mirët medalje (të artë, të argjendtë dhe të bronzte).

- Numri i orëve: 6